



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

892 / 19

Datë/Datum.

30.01.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRIŠTINA



PSH .nr. 892/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “AGRI BAU SHPK”-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik- Ritender” me nr. të prok: 644-19-9211-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri, më datën: 15.01.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “AGRI BAU SHPK”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik-Ritender” me nr. të prok: 644-19-9211-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues Komuna Vushtrri ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit për zgjatjen e afatit për liferim, në pajtim nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik-Ritender” me nr. të prok: 644-19-9211-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “AGRI BAU SHPK”-Prishtinë aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i deponitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “AGRI BAU SHPK”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 06.12.2019 me nr. 892/19, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik-Ritender” me nr. të prok:644-19-9211-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.12.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:18.12.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Operatori ekonomik ankues “AGRIBAU” SHPK, pretendon se AK-së ka kërkuar afatin e liferimit për 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës, për produktin e kërkuar dhe sasinë e kërkuar në dosje, dhe duke u bazuar në natyrën e produktit që është pajisje speciale për shpërndarjen e plehut organik, afati i liferimit është shumë i shkurtër dhe nuk mund të realizohet nga asnjë OE përveç nëse ndonjë operator i caktuar e posedon në eksperti shqyrtues sqaron se tek Fleta e të Dhënave të Tenderit dhe tek njoftimi për kontratë (Kushtet për Pjesëmarrje), nuk është e specifikuar kjo kërkesë, (afati prej 10 ditësh pas nënshkrimit të kontratës), pra ky afat prej 10 ditësh, është i specifikuar tek kushtet e veçanta të kontratës. Pjesa ku është e shënuar “Furnizimet duhet përfunduar në një afat jo më gjatë se 10 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të Kontratës”, NUK është kriter kualifikues, andaj kushtet e veçanta të kontratës janë përgjegjësi dhe kompetencë e AK-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e bazuar, dhe të vazhdohet më tutje me aktivitetin e prokurimit

Autoriteti Kontraktues, me datë: 20.12.2019, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, po ashtu Operatori Ekonomik, me datë: 20.12.2019, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratë.

Operatori ekonomik ankues "AGRIBAU" shpk, pretendon se AK-së ka kërkuar afatin e liferimit për 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës, për produktin e kërkuar dhe sasinë e kërkuar në dosje, dhe duke u bazuar në natyrën e produktit që është pajisje speciale për shpërndarjen e plehut organik, afati i liferimit është shumë i shkurtër dhe nuk mund të realizohet nga asnjë OE përveç nëse ndonjë operator i caktuar e posedon në stok te tij.

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës konstaton se në njoftimin për kontratë (II. 3 Kohëzgjatja e kontratës apo afatet kohore për përfundim), kohëzgjatja në muaj apo ditë, fillimi- përfundimi është specifikuar 10 ditë nga dhënia e kontratës, më saktësisht afati prej 10 ditësh, është i specifikuar tek kushtet e veçanta të kontratës. Duke u bazuar në faktin se natyra e produktit është pajisje speciale për shpërndarjen e plehut organik, paneli shqyrtues konsideron se kohëzgjatja prej 10 ditësh është afat kohor i shkurtër për realizimin e kontratës dhe është i qëndrueshëm pretendimi ankimor i OE ankues se ky kusht i AK-së është kusht diskriminues. Paneli shqyrtues sqaron për AK-në se neni 7 i

LPP-së- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, parasheh eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik, andaj paneli shqyrtues konstaton se AK në hartimin e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë ka qenë dashur që të veprojë në harmoni me këtë dispozitë ligjore.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se AK nuk ka vepruar në harmoni me nenin 27- përgatitja e dosjes së tenderit si dhe me nenin 1 dhe 7 të LPP-së, andaj paneli shqyrtues konsideron se AK është e obliguar të bëjë ndryshimin e afatit të liferimit (kohëzgjatjes) së përmbushjes së kontratës pasi që afati i saktësuar prej 10 ditësh nuk është në harmoni me dispozitat e lartcekura.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PACARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Vushtrri

1x1 OE - "AGRI BAU SHPK"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.